



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

*Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë*

*Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814*

Nr. 361/5 Prot.

Tiranë, më 25.07.2016

**V E N D I M**

Nr. 92, datë 25.07.2016

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ të nisur me urdhrin e verifikimit nr. 361/1 dt. 29.04.2016, për disa pretendime të ngritura nga \*\*\*\*\* , gjatë ekzekutimit përmbarimor.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 79 - 90 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit protokolluar pranë Komisionerit me nr. 361 prot., datë 29.04.2016, për disa pretendime të ngritura gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutivë,

**VËREJ SE:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me informacionin që përmbante kërkesa e parashtruar prej nëpunëses \*\*\*\*\* , protokolluar me nr. 361 prot., datë 29.04.2016, bazuar në nenin 16 të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", kreu verifikimin paraprak të çështjes. Në përfundim të verifikimit rezulton se punonjësja në fjalë, ka qenë punësuar në pozicionin "Specialiste në Sektorin e Mbikëqyrjes së Investimeve" në Ministrinë e Brendshme, deri në momentin kur Sekretari i Përgjithshëm i kësaj ministrie, me aktin nr. 810, datë 28.02.2008, ka urdhëruar lirimin e saj nga detyra për shkak ristrukturimi, duke e kaluar në listën e pritjes.

Akti i lirimimit nga detyra është ankimuar në Komisionin e Shërbimit Civil, që ishte organi kompetent për shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civilë sipas ligjit nr. 8549, dt.11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", i cili me vendimin nr. 102, datë 12.05.2008, ka vendosur pranimin e ankesës, duke shfuqizuar aktin nr. 810, datë 28.02.2008 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme dhe kthimin e punonjësës \*\*\*\*\* në vendin e mëparshëm të punës, "Specialiste në Sektorin e Mbikëqyrjes së Investimeve" në Ministrinë e Brendshme. Më

pas, Komisioni i Shërbimit Civil, me vendimin nr. 158, dt. 16.07.2013, ka urdhëruar Ministrinë e Brendshme si punëdhënëse, të paguajë pagën për gjithë kohën e qëndrimit pa punë padrejtësisht.

Të dy këto vendime, aktualisht janë kthyer në tituj ekzekutivë, detyrimisht të zbatueshëm dhe janë në procedurë ekzekutimi përmbarimor. Ndërkaq, duke pretenduar se ankuesja për pjesën më të madhe të kohës ka qenë e punësuar në pozicione të ndryshme në administratën shtetërore, institucioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme, bazuar në nenet 609 e 610 të K.Pr. Civile, ka kërkuar në gjykatë pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë dhe pushimin e veprimeve përmbarimore. Aktualisht, rezulton që kjo çështje është në shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Referuar parimit të sanksionuar në nenin 36, të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se në këtë rast, meqenëse organet gjyqësore do t'i japin zgjidhje përfundimtare mosmarrëveshjes së lindur, nuk vlerësohet i nevojshëm investigimi apo ndërhyrja nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe në nenet 16 e 34, të Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **V E N D O S A:**

1. Përfundimin e procedimit administrativ të kryer në bazë të urdhrit të verifikimit nr. 361/1 prot., datë 29.04.2016.
2. Të njoftohen për këtë vendim Ministria e Punëve të Brendshme, dhe \*\*\*\*\*.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**